

ANALIZË E LEGJISLACIONIT VENDOR DHE PËRVOJA NDERKOMBËTARE MBI SEKSIZMIN DHE PERFAQËSIMIN GJINOR NË SEKTORIN AUDIOVIZUAL



Autore: Dorela Lazaj

Redaktore: Valbona Sulce Kolgeci

Konsulente:

Eglantina Gjermeni

Ermira Danaj

Edlira Gjoni

Tiranë, Shtator 2020

“Ky material është plotësisht i financuar nga Agjensia Ndërkombëtare për Zhvillim dhe Bashkëpunim (Sida) dhe AWEN. Sida dhe AWEN nuk janë domosdoshmërisht dakort me opinionin e shprehur.”

Tabela e përmbajtjes

1.HYRJE	4
2.VESHTRIMI I KUADRIT LIGJOR VENDOR	8
2.1 Analizë e zbatimit të kuadrit Ligjor për barazinë gjinore në Sektorin Audiovizual	8
2.2 Analizë e kuadrit ligjor për adresimin e seksizmit në sektorin audiovizual në Shqipëri.....	12
3.1 Rekomandimi i Këshillit të Ministrave të Këshillit të Europës mbi Parandalimin dhe luftën ndaj Seksizmit	16
3.2 Raporti Analitik i Komisionit të Barazisë Gjinore i Këshillit të Europës 2019	18
3.2.1 Vendet Anëtare.....	18
3.2.2 Lloji i legjislacionit i adoptuar për promovimin e barazisë gjinore në media	19
4.2.3 Parashikimet për parandalimin e reklamave seksiste	21
4.2.4 Autoritetet Kombëtare rregulluese	21
4.2.5 Indikatorët e Barazisë gjinore në media	22
PËRFUNDIME	24
REKOMANDIME	25
Aneks	27
Rekomandime për forcimin e integritit gjinor në ligjin për mediat audio-vizuale në Shqipëri	27

1.HYRJE

Sipas përkufizimit të Observatorit European të Audovizualit, sektori audiovizual i referohet të gjitha mediave, përvec shtypit. Kjo do të thotë se kinemaja, televizioni, radioja, videot, dhe shërbimet e ndryshme on-demand (sic janë video on demand, ose Catch Up TV) janë të gjithë sektorë të industrisë audiovizuale.¹

Në këtë kuptim, në Shqipëri sektori audiovizual rregullohet nga ligji “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë” nr 97/2013 dhe i ndryshuar në vitin 2019, Kodi i Transmetimit për Mediat Audiovizive në Shqipëri, si dhe ligji nr.8096 “Për Kinematografinë”. Ligjet dhe Kodi garantojnë respektimin e rregullave dhe normave te vendosura për të rregulluar sektorin audiovizual.

Një nga dukuritë më shqetësuese të sektorit audioviziv në Shqipëri është fenomeni i seksizmit, gjuhës së dhunës me bazë gjinore, mos pasqyrimi i balancuar i realitetit social, portretizimi i grave në pozita inferiore, degraduese, stereotipizuese etj.

Kjo dukuri ka qenë e pranishme në mjedisin mediatik gjatë gjithë tranzicionit, dhe me kalimin e kohës, ka dëmtuar dukshëm pasqyrimin e grave dhe përfaqësimin e tyre në vendimarrje dhe jetën publike.

Sipas studimit të vitit 2018 për portretizimin e gruas dhe mbulimin e çështjeve gjinore në hapësirën mediatike televizive të publikuar nga ISHM, reflektimi mediatik i grave në rastet e studiuara rezulton qartazi shqetësues:

- Në monitorimin e muajit qershor 2018 për dy emisionet talk shoë me frekuencën më të madhe javore, shihet qartë se studio televizive mbizotërohen nga burrat në krahasim me gratë. E vetmja temë në Opinion ku kemi një raport të përmbysur gra-burra është ajo e soft neës.
- Raportimi mbi dhunën me bazë gjinore është i tipit sensacionalist, pa kontekst dhe i ngjyrosur me nota sentimentale për vrasësit.
- Fokusimi vetëm te futbollit i emisioneve sportive bën që hapësira për gratë dhe vajzat të ngushtohet duke ia lënë “skenën” prezantueseve, të cilat ose janë gazetare, ose vijnë nga bota e modelingut ose shoë bizit. Kjo gjini e sportit kushtëzon edhe pjesëmarrjen e grave/vajzave vetëm në kufijtë e shoëbizit, pasi analizën sportive e bëjnë përgjithësisht meshkujt. Në këto kushte, të

¹ <https://www.obs.coe.int/en/web/observatoire/what-we-do>

vetmet komente që mund të bëhen për të ftuarat janë veshja dhe paraqitja e tyre”.²

Nuk është i rrallë pasqyrimi seksualizues, ose stereotipizues i grave në emisionet satirike, investigative ose të humorit, në të cilat nuk respektohet parimi i një pasqyrimi të balancuar gjinor, si edhe promovimi i imazhit pozitiv të grave si pjesmarrëse në jetën politike, sociale dhe ekonomike. Pasqyrime të tilla madje janë të pranuarra gjerësisht, dhe shpesh ofrohen si modele suksesi për brezin e rinj.²

Në kontekstin aktual, kur mbulimi mediatik vendas, por edhe botëror, po adreson forma të pasqyrimet gjinor që përforcojnë rolet stereotipike gjinore, masivitetit dhe lehtësisë së krijimit të outleteve mediatike, lufta ndaj seksizmit dhe gjuha e dhunës ndaj grave merr rëndësi thelbësore, sidomos në kushtet e një rritjeje galopante të dhunës ndaj grave në nivel global.

Situata në Shqipëri me dhunën ndaj gruas është po aq shqetësuese. Vetëm vitin e fundit kemi patur tre raste të bujshme përdhunimesh të vajzave të mitura në shkolla ose nga bashkëmoshatarë, ose në familje, ndërsa numri i grave të vrara nga viti në vit është rritur. Sipas të dhënave të medias, numri i grave që kanë kërkuar urdhër mbrojtje në vitin 2019 ka qenë 803 raste, për dy muajt e parë të vitit 2020 janë shqyrtuar 102 raste, nga të cilat janë pranuar gjysma, ndërsa periudha e karantinës tregoi se thirrjet për ndihmë u trefishuan në raport me një vit më parë.

Studime të shumta kanë provuar një lidhje midis seksizmit në media dhe rritjes së dhunës ndaj grave në anën tjetër. Institute kërkimore prestigjioze kudo në botë si psh në SHBA, që në vitin 1972 kanë provuar lidhjen mes dhunës në ekran dhe sjelljes agresive. Kjo u konfirmua në vitin 1982 Instituti i Shëndetit Mendor dhe në 1985 nga Shoqata Amerikane e Psikologjisë. Në vitin 2004, Qendra për Kontrollin e Sëmundjeve CDC gjeti se dhuna në media nxit sjelljen agresive dhe në 2007, Komisioni Federal për Komunikimet FCC i rekomandoi Kongresit rregullimin e dhunës në TV. Po në këtë vit, Kongresi mbati një dëgjese të posacme për mbizotërimin e seksualizimit të grave në videot muzikore. Në vitin 2009, studimet

² Portretizimi i grave në median elektronike shqiptare, Instituti Shqiptar i Medias, 2018
<https://www.youtube.com/watch?v=s21KtxXk5Nk>, <https://www.youtube.com/watch?v=ppP7-el3YII>
<https://gazetamapo.al/ish-zedhenesja-seksi-e-pd-se-laura-vorpsi-nene-per-here-te-pare/>
<https://www.faxweb.al/viola-spiro-fotografohet-me-barkun-e-rrumbullakosur-ne-plazh/>

provuan se videolojërat dhe videoklipet me natyrë seksuale të qartë janë të lidhura me pranimin nga ana e burrave të miteve mbi përdhunimin dhe ngacmimin seksual.³

Në këtë kontekst, duke qenë se televizioni vazhdon të mbetet media më e konsumuar nga shqiptarët, pavarësisht rritjes së mediave sociale, nevojitet të tregojnë kujdes së shtuar për portretizim jo diskriminues dhe seksist të grave në media.

Kodi dhe ligjet garantojnë ashtu sic premtojnë, pasqyrimin kundër dhunës, për mbrojtjen e fëmijëve, **standardet etike dhe morale të shoqërisë, dinjitetin, paanësinë** etj.

Gjithashtu ligji për mediat audivizuale përcakton në nenin 33/1 se: *Ofruesit e shërbimit të publikimeve elektronike ndër të tjera nuk duhet të nxisë, të shtojë nxitjen ose të përhapë urrejtje apo diskrimin në bazë të racës, prejardhjes etnike, ngjyrës së lëkurës, **gjinisë**, gjuhës, fesë, prejardhjes kombëtare ose sociale etj.*

Parimi i barazisë gjinore përmendet përciptazi në seksionin e parimeve, duke mos i dhënë rëndësi specifike ose vëmendje të vecantë për t’ju përgjigjur nevojës publike.

Nëpër të gjithë leximin e ligjit “Për Mediat Audiovizive” dhe Kodit të Transmetimit, **koncepti i seksizmit nuk përmendet asnjëherë.**

Legjislacioni ndërkombëtar dhe europian e ka adresuar seksizmin nëpërmjet rekomandimeve që prezantojnë parimet dhe protokollet që duhet të ndjekin vendet anëtare dhe vendet candidate për të adresuar këtë fenomen.

Pavarësisht këtyre rekomandimeve të Këshillit të Europës, të cilat përbëjnë edhe kornizën legjislative nga ku rrjedhin edhe ligjet e brendshme, duket se legjislacioni shqiptar akoma nuk e ka reflektuar dhe nuk i ka dhënë mbulim ligjor kësaj çështjeje.

Ngjarjet e fundit të publikimit të identitetit të viktimave të dhunës seksuale, fyerjeve me bazë gjinore, portretizimit stereotipik shumë vjekar të grave, vendosja e tyre në pozita inferiore ose seksualizuese, e kanë bërë të nevojshme ndërhyrjen ligjore për të adresuar këtë çështje me amendime ligjore.

³ Miss Representation, dokumentar, 2011

Nga ana tjetër, përfaqësimi gjinor në institucionet publike të sektorit audioviziv vazhdon të mbetet në kuota të ulëta, madje me një prirje përkeqësuese nga viti në vit, pavarësisht ekzistencës së ligjit për Barazinë Gjinore, që detyron përfaqësim mbi 30% të secilës gjini në këto institucione. Në një analizë të mëparshme ligjore⁴ është argumentuar nevoja për monitorim më të rreptë të këtyre kuotave, pasi ne mendojmë se përfaqësimi gjinor në mediat publike audiovizive është i lidhur ngushtë edhe me luftën ndaj seksizmit. Një përfaqësim më i drejtë gjinor në bordet drejtuese të institucioneve publike, do të sillte afërmendsh më shumë trysni pozitive për respektimin e parimit të barazisë gjinore në media.

Me anë të këtij punimi, dëshirojmë të hedhim dritë mbi dy aspekte të rëndësishme të grave në audiovizual: seksizmin dhe barazinë gjinore në vendimmarrje. Shpresojmë të theksojmë rëndësinë e luftës ndaj seksizmit, ekspozimin e situatës reale të barazisë gjinore në audiovizual, nevojën për adresim urgjent të problematikës së barazisë gjinore si edhe identifikimin e hapësirave për ndërhyrje legislative në ligjet që mbulojnë sektorin dhe ligjet e lidhura me to.

Punimi ofron nga njëra anë, propozime konkrete ligjore për të pasqyruar realitetin social në lentin e anti seksizmit dhe në anën tjetër, për të garantuar zbatimin e ligjit “Për barazinë Gjinore” në sektorin audioviziv në Shqipëri.

⁴ Cështje të barazisë gjinore në sektorin audioviziv, GADC, 2019

2.VESHTRIMI I KUADRIT LIGJOR VENDOR

2. 1 Analizë e zbatimit të kuadrit Ligjor për barazinë gjinore në Sektorin Audiovizual

Ligji “Për Barazinë Gjinore në shoqëri” dhe ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi” parashikojnë rregullime të detyrueshme të përfaqësimit gjinor.

Për shembull, neni 15 i ligjit për barazinë gjinore në seksionin e pjesmarrjes në vendimarrje parashikon se “Përfaqësimi i barabartë gjinor **në të gjitha organet e pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor dhe në institucionet e tjera publike** arrihet kur sigurohet përfaqësim në masën mbi 30 për qind për secilën gjini, përfshirë edhe në organet e tyre drejtuese;⁵


Këto rregullime nuk janë të respektuara në sektorin audiovizual.

Për të ilustruar mungesën e respektimit të ligjit “Për barazinë gjinore në Republikën e Shqipërisë”, si edhe standardet e dyanshme të aplikuar në institucionet publike më poshtë paraqiten rezultatet e matjeve të strukturave dhe bordeve drejtuese të RTSHsë, AMA-s dhe QKK si institucione publik të sektorit audiovizual.

“Në këshillin drejtues së RTSH-së ka një prirje negative duke nisur me 30% në vitin 1999, zeruar në vitet 2007-2012 për të ardhur në kuotën e 10% në periudhën pasardhëse. Në këtë pikëpamje, barazia gjinore në organin më të lartë vendimmarrës ka pësuar regres, duke mos arritur ende as 30% e fillimit”.⁷ Përbërja e Këshillit Drejtues të RTSH:

⁵ Ligji Nr.9970, datë 24.7.2008 “Për Barazinë Gjinore”, Republika e Shqipërisë, Neni 15, Pika a.
⁷https://www.gadc.org.al/media/files/upload/Ceshtjet_e_barazise_gjinore_ne_sektorin_audio_viz_iv_ne_shqiperi.pdf fq/14


Përbërja e KD të RTSH 1999-2018 (në %)



Në strukturën organizative të RTSH-së **asnjë** prej titullarëve të këtyre sektorëve nuk është grua.

Po ashtu, sa i përket grave në pozicione drejtuese sipas Drejtorive:

Burimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore, RTSH, 2019



Autoriteti i Mediave Audiovizuale

Sa i përket përbërjes gjinore të AMA-s, në total kanë shërbyer si anëtarë 27 persona. Nga këta 23 kanë qenë burra dhe vetëm 4 kanë qenë gra.

Pra në përqindje, **86% përqind dhe 14%.**

Sipas studimit të GADC, në vitin 2018 në Bordin e Anëtarëve të AMA, **vetëm një** nga shtatë anëtarë ishte grua. Në 2020 vetëm njëra nga anëtarët është grua.

Me arsyetimin se anëtarët e AMA-s zgjidhen më konsensus politik nga anëtarët e kraheve politike, përqindja e kuotave të prezantuara nga ligji për barazinë gjinore anashkalohet, edhe pse qartazi ligji mbulon edhe organet publike vendimarrëse në audiovizual.

Qendra Kombëtare e Kinematografisë

Sipas pas të dhënave të mundësuar nga studimi “Cështje të Barazisë Gjinore në Sektorin Audiovizual” situata në QKK deri në vitin 2018 është po gjithashtu e pa balancuar:

Komisioni i zgjedhjes së projekteve përbëhet nga 7 anëtarë me mandate 2 vjeçar. Në 20 vite në këtë komision kanë shërbyer 70 anëtarë. Gratë kanë përbërë vetëm 7% të komisionit që nga themelimi.

Megjithatë, QKK paraqet shembullin më të mirë sesi lobimi dhe monitorimi nga afar i kuotave mund ta përmbysë situatën, pasi si rezultat i punës së AËA-s në 2019, aktualisht Komisioni i zgjedhjes së Projekteve, për herë të parë ka një përbërje gjinore në favor të grave, 60% me 40%.

Shifrat e mësipërme janë bazë për argumentin se në nivelet drejtuese të RTSH-së, AMA-s dhe QKK-së, *dispozitat e barazisë gjinore nuk respektohen.*

Megjithatë, neni 15 i ligjit të barazisë gjinore ka gjetur zbatim në rastin e organeve të pushtetit legjislativ, pasi nëse i referohemi legjislacionit zgjedhor, neni 67 pika 6 e Kodit Zgjedhor parashikon se: “Për çdo zonë zgjedhore, të paktën tridhjetë për qind e listës shumëmemërore dhe një në tre emrat e parë të listës shumëmemërore duhet t’i përkasë secilës gjini. Subjekti paraqitës në tre emrat e parë të listës shumëmemërore duhet t’i përkasë secilës gjini. Subjekti paraqitës i listës deklaron vendet, sipas kuotës gjinore, me qëllim zbatimin e përjashtimit, sipas pikës 2 të nenit 164 të këtij Kodi. Për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, për çdo këshill bashkie, një në çdo dy emra të njëpasnjëshëm në renditje duhet t’i përkasë së njëjtës gjini. Subjekti paraqitës i listës deklaron vendet, sipas kuotës gjinore, me qëllim zbatimin e përjashtimit, sipas 2, të nenit 164, të këtij Kodi.

Gjithashtu Kodi Zgjedhor e ka përforcuar detyrimin me pikën e fundit të nenit 67 ku “ të dytë, të pikës 2, të nenit 164, të këtij Kodi. “*Në rast mospërmbushjeje të njërit*

*prej kushteve të parashikuara në këtë nen, në lidhje me përbërjen e listës shumemërore KQZ-ja zbaton sanksionet e parashikuara në lidhje me përbërjen e listës shumemërore KQZ-ja zbaton sanksionet e parashikuara në nenin 175 të këtij Kodi”. Ky nen përfshin gjobitjen nga KQZ me gjobë deri në 1000000 lekë, si edhe sanksion plotësues, me refuzimin e listës së partisë politike të kandidatëve për këshillat bashkiakë, për zgjedhjet për organet e pushtetit vendor.*⁶

Efekti i një parashikimi të tillë është i dukshëm. Më 2017 për herë të parë në historinë e tranzicionit, gratë dhe vajzat kanë 28% të vendeve në parlament. Për herë të parë në historinë e Shqipërisë kemi numrin më të lartë të grave ministre (10 nga 20 ministra në qeverinë me prurje teknike dhe 7 nga 14 ministra në qeverinë e re 2017). Janë zgjedhur 39 gra deputete, 22 prej të cilave për herë të parë si përfaqësuese në parlament. Ky përfaqësim është një arritje e rëndësishme e grupeve lobuese politike e civile për kuotë përfaqësimi 30% në parlament dhe një referencë frymëzuese për qëndrueshmërinë dhe rritjen e përfaqësimit të barabartë të grave në të gjitha sferat e politikës vendimmarrëse.⁷

Po kështu Ligji për organet e vetëqeverisjes vendore, 2015, në nenin 54 “Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak” saktëson se: “zgjedh përfaqësuesit e këshillit bashkiak në këshillin e qarkut, të cilët, në jo më pak se 50 për qind të tyre, duhet t’i përkasin gjinisë më pak të përfaqësuar”.⁸

Gjithsesi, nëse krahasojmë përbërjen e legjislativave si edhe të zgjedhurve vendore, me të zgjedhurit në organet publike të sektorit audiovizual, vihet re një hendek i dukshëm përfaqësimi në dëm të këtij të fundit.

Në këto kushte, mbeten dy rrugë për të adresuar këtë pabarazi:

1. Nën Komisioni Parlamentar i Barazisë Gjimore të marrë një rol të përforcuar në zbatimin e ligjit të barazisë gjimore. Monitorimi në bazë vjetore i zbatimit të ligjit të barazisë gjimore në institucionet publike të audiovizualit është një mënyrë e përshtatshme për të zgjidhur/ adresuar këto shkelje.

⁶ Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.07.2012 dhe ligjin nr. 31/2015, datë 02.04.2015

⁷

http://ëëë.un.org.al/sites/default/files/1.%20Gender%20one%20Partite%20Politike%202017%20%20Shqip_1.pdf fq 6

⁸ http://ëëë.erru.al/doc/Ligj_nr.139-2015_date_17.12.2015_Per_vetqeverisjen_vendore.pdf

2. Nëse Komisioni vlerëson se duhet ndërhyrë specifikisht në ligjin e Mediave Audiovizive dhe atë për Kinematografinë, me shtim specifik të dispozitave ku flitet për zgjedhjen e anëtarëve të Bordeve Drejtuese të mediave publike, propozimi ynë është i njëjtë me analizën e parë ligjore, bashkëlidhur këtij studimi.

2.2 Analizë e kuadrit ligjor për adresimin e seksizmit në sektorin audiovizual në Shqipëri

Sipas përkufizimit të rekomandimit të Këshillit të Ministrave CM/REC2014 KiE seksizëm konsiderohet:

Cdo akt, gjest, përfaqësim vizual, fjalë të shkruara ose të thëna, praktika ose sjellje të bazuara në idenë se një person ose grup personash është inferior për shkak të gjinisë, që ndodh në sferën publike ose private, online ose offline, me efekt dhe qëllim të:

- Dhunim të dinjitetit inherent ose të drejtat e një personi ose grup personash ose;
- Që rezulton në dëm ose vuajtje fizike, seksuale, psikologjike ose socioekonomike ndaj një personi ose grup personash ose;
- Krijimin e një mjedisi intimidues, armiqësor, degradues, fytes dhe poshtërues, ose;
- Ruajtja dhe përforcimi i stereotipeve gjinore.⁹

Nëse i referohemi nenit 26 të ligjit për barazinë gjinore, rregullimi i medias bëhet si vijon:

1. Media ndihmon në rritjen e vetëdijes së përgjithshme për barazinë e femrave dhe të meshkujve:

- a) përmes raportimit jodiskriminues mbi baza gjinore;*
- b) përmes përdorimit të terminologjisë neutrale në aspektin gjinor;*
- c) përmes shmangies së stereotipave gjinorë në veprimtarinë e vet.*

⁹ <https://rm.coe.int/cm-rec-2019-1-on-preventing-and-combating-sexism/168094d894>

2. Ndalohet transmetimi, botimi dhe publikimi i materialeve dhe i informacioneve, që përmbajnë apo nënkuptojnë dallime poshtëruese apo fyese, përjashtime apo kufizime të njëjës prej gjinive, në bazë të diskriminimit për shkak të gjinisë.

Ky nen në ligj mbulon më së miri parimin e mos diskriminimit, i cili duhet të mjaftojë që sektori audiovizual të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje me nenin 26. Megjithatë, eksperiencia ka treguar që jemi përpara një epidemie seksizmi nga media, të cilat nuk e marrin parasysh këtë ndalim ligjor. Gjykojmë se arsyeja përse kjo dispozitë nuk respektohet, vjen për dy arsye:

1. Mungesa e treguesve të matshëm të raportimit jodiskriminues apo përcaktimit më të qartë se çfarë kuptojme me dallime poshtëruese, fyese, përjashtime apo kufizime të njëjës prej gjinive;
2. mungesës së sanksioneve në rast shkeljeje të nenit (si në rastin e sanksioneve të subjekteve politike nga KQZ).

Nëse i referohemi ligjit “Për Mediat Audiovizive”, ligjit për Kinematografinë dhe Kodin e Transmetimit, që përfaqësojnë edhe tre ligjet kryesore rregulluese të aktivitetit të transmetimeve audiovizuale në Shqipëri, aktualisht koncepti i seksizmit nuk ekziston.

Psh ligji “Për Mediat Audiovizive” i ndryshuar në vitin 2019, paraqet të drejtat dhe detyrimet e operatorëve të shërbimeve audio, audiovizive dhe shërbime të publikimeve elektronike, si edhe përcakton kompetencat dhe fushën e veprimit të AMA-s (përfshirë Këshillin e Ankesave dhe Bordin Drejtues). Edhe pse ligji parashikon rregullime konform praktikave dhe rekomandimeve europiane, nëpër të gjithë trupin e ligjit ***mungon qartazi qasja e barazisë gjinore dhe rëndësia e pasqyrit të balancuar gjinor të realitetit social.***

Shtimi i neneve që ndalojnë përmbajtjen seksiste dhe stereotipizimin e grave në audiovizual, është i lidhur ngushtësisht me nevojën urgjente për të amenduar ligjin në frymën e barazisë dhe përfaqësimit të barabartë gjinor.

Edhe Kodi i Transmetimit paraqet të njëjtën problematikë.

Në hyrje të Kodit, parashikohen parimet bazë dhe rregullat për programet informative, nje seksion të zgjeruar të trajtimit të femijëve ne transmetimet audiovizive, dhe një seksion për reklamat.¹⁰ Kodi i Transmetimit nuk përmban asnjë dispozitë që ndalet tek seksizmi, si një ndër format e shkeljes të së drejtave të grave dhe vajzave.

Sipas bazës ligjore të përcaktuar, veprimtaria e Kodit rregullohet në bazë të ligjit 97/2013 si edhe aktet ligjore dhe nënligjore si më poshtë:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
- Ligji nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.
- Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 8096, datë 21.03.1996 “Për kinematografinë”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.
- Udhëzimi nr. 9, datë 15.09.2010, i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave.

Sic vihet re, **në bazën ligjore mungon ligji Nr.9970, datë 24.7.2008 “Për Barazinë gjinore në shoqëri”** që përbën edhe thelbin e argumentimit të AWA-s në lidhje me përfaqësimin gjinor në sektorin audiovizual. Kjo “harresë” legislative në dukje, paraqet një problem madhor, pasi përcakton frymën e veprimtarisë së Kodit, duke lënë jashtë një aspekt të rëndësishëm të përfaqësimit shoqëror , sic jane gratë.

Ne seksionin e parimeve themelore të KT, në pikën 1.12 përmendet respektimi i të drejtës së barazisë dhe mosdiskriminimit. Kjo është pika e vetme ku legjislatori merr disi në konsideratë parimin e barazisë. Megjithatë mbetet e paqartë nëse barazia i referohet gjinisë, shtetësisë, apo një lloj kapaciteti tjetër.

Kjo lë vend për interpretime dhe pavarësisht se AMA ka një organ mbikeqyrës të zbatimit të Kodit të Transmetimit që është Këshilli i Ankesave, mungesa e një përkufizimi të qartë të seksizmit si shkelje e parimit të barazisë gjinore, praktikisht

¹⁰ Kodi i Transmetimeve Audiovizuale, Fëmijët në transmetimet audiovizive, seksioni 5

e lë pa kompetencë këtë organ për të vepruar në rast të konstatimit të dukurive të tilla në operatorët mediatikë .

Më konkretisht, Këshilli i Ankesave në rregullimin ligjor parashikohet se: “Mbikqyr zbatimin e kodit të transmetimit, sa i përket respektimit të dinjitetit e të drejtave themelore të njeriut, në mënyrë të vecantë të të drejtave të fëmijeve, të të drejtës për informacion dhe sensibilizim të opinionit publik, lidhur me respektimin e normave morale dhe etike në programet audiovizive”.¹¹

Duket qartë mungesa e rregullimit ose përfshirjes së seksizmit dhe pasqyrimin të balancuar gjinor. E thene ndryshe, Kodi deri më tani në përmbajtje nuk e pasqyron realitetin e seksizmit në media.

Sipas pikës 2.4, “Këshilli i Ankesave me ekspertizë të pavarur *mund* të organizojë anketime të publikut për probleme etike të programeve”. Por në kushtet e një edukimi të munguar mediatik të audiencave, sërish opinionet e mbledhura nga ankesat e publikut nuk mund të reflektojnë realitetin lidhur me stereotipet gjinore dhe diskriminimin gjinor apo seksizmin, ndaj sa kohe kjo nuk është e parashikuar në ligj, mbetet evazive. Publiku shqiptar shquhet për një mendësi patriarkale që mban në këmbë norma të dëmshme gjinore, ndaj rrezikojmë që të mos e quajnë problem etik seksizmin apo stereotipet gjinore. Në këtë kontekst, nevojitet një qëndrim proaktiv i AMA-s për të investuar më fort në edukim mediatik (*media literacy*) dhe ndërgjegjesimin e popullatës lidhur me seksizmin në përgjithësi dhe atë në media në vecanti. Në këtë mënyrë, do të nxitet reagimi i duhur nga ana e publikut për shkelje të këtij lloji dhe në një farë mënyre, publiku kthehet në “monitorues” vullnetar të përmbajtjeve mediatike që sinjalizojnë përmbajtje seksiste.

Gjithashtu, një publik më i edukuar mediatikisht që konsumon në mënyrë kritike përmbajtjet audiovizuale, do ta ndihmonte Këshillin të kryente detyrat aktuale të parashikuara në Kod ku parashikohet që “Këshilli gjithashtu mund të investohet me kërkesë të jashtme për monitorimin e veprimtarisë së një operatori, përfundimet të cilat i raporton në AMA duke sugjeruar masat për përmirësim.”

¹¹ Kodi i Transmetimit për median audiovizive, Seksioni 2, Këshilli i Ankesave.

Nga ana tjetër, Këshilli i Ankesave nuk e ka tagrin të iniciojë së brendshmi monitorime ose penalizime për operatorët në shkelje të të drejtave themelore, dhe aq me pak seksizmit. Roli i tij përgjatë nenit është pasiv dhe monitorues. Ndërkohë që praktikat më të mira europiane sugjerojnë një qasje më të drejtperdrejtë, pro-aktive, të dedikuar ndaj luftës kundër seksizmit dhe të shpejtë/atypëratyshme të Këshillit të Ankesave, ose institucionit të ngarkuar me monitorim.

Nga kjo analizë, del qartazi nevoja për të përdorur gjuhë legjislative më të detajuar, ku të qartësohet qëndrimi i AMA-s në lidhje me barazinë gjinore dhe diskriminimin gjinor në media dhe mekanizmat monitorues për të mbikëqyrur zbatimin e saj.

3. VESHTRIM I KUADRIT LIGJOR EUROPIAN për barazinë gjinore në media dhe përvoja NDËRKOMBËTARE

3.1 Rekomandimi i Këshillit të Ministrave të Këshillit të Europës mbi Parandalimin dhe luftën ndaj Seksizmit

Nëse vështrojmë kontekstin rajonal dhe europian, arrijmë në përfundimin se Shqipëria duhet së paku të reflektojë në lidhje me rekomandimet europiane që rregullojnë barazinë në media, dhe iu kërkojnë vendeve anëtare inkurajimin e barazisë, mbështetjen e hulumtimeve si dhe ngritjen e strukturave të posacme të monitorimit brenda autoriteteve rregulluese.

Këshilli i Europës e ka adresuar barazinë gjinore dhe seksizmin në media me anë të CM/Rec 2017(9) “Mbi Barazinë Gjinore në Sektorin Audiovizual” dhe rishtazi më 27 Mars 2019 (CM Rec 2019/1) “Mbi Parandalimin dhe Luftën ndaj Seksizmit”.

Në rekomandimin e vitit 2019, përcaktohet kuptimi i seksizmit, si edhe rekomandimet ndaj shteteve anëtare për të adresuar seksizmin në fushat e medias sociale, vendit të punës, media dhe komunikimeve elektronike, gjuhë dhe komunikime, sektorin publik, institucionet edukuese, sistemin gjyqësor, kulturë & sport dhe jetën private.

Më konkretisht, sa i përket seksizmit në media i trajtuar në seksionin IIC të quajtur “Media, reklamim dhe produkte të tjera komunikimi” dhe shërbime parashikon veprimet konkrete të vendeve anëtarë për ndalimin e tij si me poshtë:

1. *“Inkurajimin e krijimit të një institucioni që është kompetent për të marrë, analizuar dhe shqyrtuar ankesat në lidhje me seksizmin në media dhe reklamim, i cili ka edhe autoritetin të kërkojë që përmbajtja apo reklamat seksiste të tërhiqen ose modifikohen.*
2. *Mbështetjen e hulumtimeve mbi përhapjen dhe ndikimin e portretizimeve seksiste të grave dhe vajzave në media dhe në materiale pornografike, deri në çfarë mase ato përkeqësojnë pabarazitë gjinore dhe dhunën ndaj grave dhe vajzave dhe gjithashtu mbi ndikimin e tyre në shëndetin fizik, seksual dhe psikologjik të grave. Ndarjen e burimeve për të financuar fushata efektive të komunikimit dhe vetëdijësimit mbi lidhjet midis seksizmit, mungesës së barazisë gjinore dhe dhunës ndaj grave dhe vajzave; dhe promovimin e portreteve pozitive dhe jo stereotipizuese ndaj grave dhe burrave në media dhe reklamim.*
3. *Inkurajimin e pjesëmarrjes së barabartë të grave dhe burrave në pozita vendimmarrëse në media dhe në përmbajtje dhe krijimin e bazave të të dhënave të eksperteve gra për të gjitha temat”*

Nga teksti i rekomandimit të mësipërm (pikat 5/7/8), evidentohet qartë nevoja për harmonizim legjislativ në përputhje me rekomandimin e Këshillit të Ministrave të KiE, si edhe monitorimi ose sanksionimi aty ku është e mundur, e parashikimeve ligjore që rregullojnë barazinë gjinore në audiovizual. Sic u përmend edhe më sipër, këshilli i ankesave (ose ndonjë organ i ngjashëm brenda AMA-s) nuk është i mandatuar për të monitoruar aktivitetin e medias me fokus barazinë gjinore dhe luftën ndaj seksizmit. Gjithashtu praktika e mirë e nisur nga AMA për hulumtimet në fushën e portretizimit seksist, duhet vazhduar me një planifikim vjetor së bashku me fushatën kundër seksizmit, sic rekomandohet në pikën 2. Ndërsa pika e tretë ka lidhje pikërisht me zbatimin e ligjit të barazisë gjinore, analizuar në pjesën e parë të studimit.

3.2 Raporti Analitik i Komisionit të Barazisë Gjinore i Këshillit të Europës 2019

Në vitin 2019 raporti analitik i Komisionit të barazisë gjinore i Këshillit të Europës nxorri në pah situatën e sektorit audiovizual në vendet anëtare të KiE-së pas rekomandimit të KiE të vitit 2013 “Mbi barazinë gjinore dhe Median”. Raporti analitik është bazuar në përgjigjet e pyetësorit adresuar në 2019 vendeve anëtare, organizatave të medias, enteve rregullatore të medias, trupave vetë rregulluese të medias, për të vlerësuar progresin e bërë që nga adoptimi i rekomandimit CM/REC 2013 mbi barazinë gjinore dhe median.

Përgjigjet u morën nga 33 vende anëtare, 17 autoritete rregullatore të medias, 4 trupa vetë rregulluese të medias, 3 organizata të medias. **Shqipëria nuk mori pjesë në anketim.**

Raporti tregon se “në nivel legjislativ vendor dhe rregullimeve mediatike ka ndodhur progres i moderuar me qëllim përmirësimin e barazisë gjinore në media|.

Iniciativa si dhënia e licencave të transmetimit mbi **baza të kriterëve të barazisë gjinore**, bashkë financimi i projekteve mediatike që fuqizojnë barazinë gjinore, ose mbështetja e programeve të barazisë gjinore në media janë hapa konkret, të cilat mund të kontribuojnë në ndryshimin e mendësive dhe inkurajimin e profesionistëve të medias për të raportuar përmes një lenteje gjinore.”

Përgjigjet e kufizuara të marra në këtë raport nga trupat vetë-rregulluese tregojnë se çështja e barazisë gjinore nuk ka qenë prioritet në agjendat e tyre.

Raporti konstaton se shumë pak është bërë nga perspektiva e vendeve anëtare dhe organizatave të mediave për të ndryshuar mendësinë dhe kulturën në redaksi në lidhje me barazinë gjinore dhe adresimin e pabarazisë në vendin e punës. Kjo detyrë duhet të adresohet seriozisht nëse media kërkon të reflektojë realitetet e grave dhe burrave dhe të fillojë një ndryshim real të qasjes ndaj barazisë gjinore.

3.2.1 Vendet Anëtare

Midis 33 vendeve që ju përgjigjën pyetësorit, 7 prej tyre kanë përfshirë parashikime specifike të barazisë gjinore në ligjet e tyre të medias, ndërsa 17 prej tyre kanë **vendosur parashikime për median në ligjet respektive për barazinë gjinore**. 10 prej tyre kanë vendosur **kërkesa specifike** në lidhje me mbrojtjen e dinjitetit, mos diskriminim ose barazi gjinore **në legjislacionin e transmetimit** (ose legjislacion tjetër specifik për median).

Vetëm shtatë të anketuar ju referuan rekomandimit CM/REC 2013 se kishte luajtur një rol në zhvillimin e iniciative specifike në lidhje me barazinë gjinore në sektorin e medias.

Shumica e parashikimeve për barazinë gjinore janë të limituara në organizatat transmetuese dhe janë të përfshira në një ligj të përgjithshëm të barazisë gjinore sesa në ligj specifik për median. Kjo mund të shpjegohet nëpërmjet hezitimit të disa vendeve anëtare me ndërhyrjen në lirinë e medias dhe mundësinë e krijimit të legjislacionit konfliktual.

Masa më të buta janë përdorur për të inkurajuar barazinë gjinore në raportimin mediatik. Me këtë qëllim një numër i madh i vendeve të anketuara kanë zhvilluar politika dhe iniciative specifike për të mbështetur rritjen e ndërgjegjësimit dhe promovimin e një kulture sensitive gjinore në sektorin e medias.

3.2.2 Lloji i legjislacionit i adoptuar për promovimin e barazisë gjinore në media

Cështjet e barazisë gjinore lidhen me dy aspekte të medias:

- 1) Barazia brenda kompanive mediatike, mundësi dhe trajtim i njëjtë, akses i barabartë në pozicione vendimarrëse, 2) Barazia në përmbajtjen e medias.

Jo të gjitha vendet anëtare kanë krijuar ligje me natyrë të përgjithshme që mbulojnë median, edhe më pak prej tyre kanë përfshirë parashikime specifike gjinore në ligjet që rregullojnë mediat. Shtypi i shkruar është një hapësirë ku vendet demokratike në përgjithësi nuk dëshirojnë të implementojnë legjislacion rregullues, nga frika e akuzave për ndërhyrje politike.

Sektorin audiovizual megjithatë, është përgjithësisht subjekt i rregullimeve më strikte, duke marrë parasysh impaktin e mass medias në publik dhe opinion.

Kjo ju jep vendeve anëtare me shume mundësi për inkurajimin e një transmetimi raportimi të drejtë, të saktë dhe gjithëpërfshirës. Një numër vendësh kanë përfshirë referenca specifike të barazisë gjinore në legjislacionet e tyre të transmetimit,

përkatësisht Austria, Bullgaria, Gjermania, Greqia, Islanda, Luksemburgu, Moldavia, Spanja, Sllovakia dhe Zvicra.

Madje, transmetuesi publik rregullohet specifikisht dhe duhet të bjerë dakord me një numër kriteresh strikte për të operuar, përfshirë parimin e mos diskriminimit.

Prirja e përgjithshme është përfshirja e parashikimeve të lidhura me median në legjislacionin për barazinë gjinore. Analiza e përgjigjeve tregon se ligjet për barazinë gjinore shpesh përmbajnë elementë specifikë të medias, duke adresuar zakonisht çështje si mundësitë e barabarta, hendeku gjinor i pagës, reklamat dhe ndonjëhere përmbajtja seksiste. Këto parashikime mund të përdoren për të kompensuar mungesën e kërkesave specifike për barazinë gjinore në ligjet për mediat.

Për shembull Mali i Zi në ligjin për barazinë gjinore i kërkon specifikisht mediave të promovojnë barazinë gjinore nëpërmjet “konceptimit programatik”. Në Moldavi, ligji i barazisë gjinore përfshin një parashikim specifik mbi mundësitë e barabarta në media, duke inkurajuar programe që “ndikojnë në ndryshimin e stereotipeve kulturore e sociale”. Ligji Ukrainas inkurajon implementimin e kodeve të etikës për të shmangur dhunën me bazë gjinore. Britania e Madhe, në bazë të Aktit të Barazisë së 2017, i detyron të gjitha kompanitë (përfshirë organizatat mediatike) të deklarojnë të dhënat e hendekut të pagës. CSA-ja franceze ka misionin e dyfishtë, që nga njëra anë të kontribuojë në favor të kohezionit social dhe luftës kundër diskriminimit në fushën e komunikimit audioviziv dhe, nga ana tjetër, për të siguruar, veçanërisht tek kompanitë e komunikimit audioviziv, që programimi të pasqyrojë diversitetin e shoqërisë franceze në të gjithë spektrin e programeve.¹²

Në Francë, Ligji n° 2014-873 i datës 4 gusht 2014 mbi barazinë reale mes burrave dhe grave sjell disa ndryshime në ligjin e vitit 1986 n° 86-1067, mbi lirinë e komunikimit, nëpërmjet Nenit 56, i cili thotë: „Siguron respektimin e të drejtave të grave në fushën e komunikimit audioviziv. Për këtë qëllim, siguron, nga njëra anë, një përfaqësim të drejtë të grave dhe burrave në programet e shërbimeve të komunikimit audioviziv dhe, nga ana tjetër, në imazhin e grave që paraqesin këto programe, veçanërisht duke luftuar kundër stereotipeve, paragjykimeve seksiste, imazheve poshtëruese, dhunës ndaj grave dhe dhunën brenda çifteve. Për këtë qëllim, i kushton vëmendje të veçantë programeve edukative të komunikimit audiovizual për fëmijë dhe të rinj.“

“Këshilli rregullon kushtet e zbatimit të këtij neni, në konsultim me shërbimet e përmendura në paragrafin e parë të këtij neni.”

¹² Danaj, Ermira, Dokument për median dhe GE në Francë

4.2.3 Parashikimet për parandalimin e reklamave seksiste

Disa legjislacione kombëtare e adresojnë reklamimin seksist ose nëpërmjet ligjit të barazisë gjinore, akteve të shërbimit në media ose legjislacionit për reklamat. Ky është rasti i Bosnjes, Bullgarisë, Danimarkës, Finlandës, Gjermanisë, Greqisë, Lituaniës, Polonisë, Rumanisë, Serbisë, Sllovakisë dhe Ukrainës. Vendet si Spanja i adresojnë drejtpërdrejt masat kundër dhunës me bazë gjinore në një ligj specifik. Ligji spanjoll kundër dhunës gjinore merret posaçërisht me media që tregojnë portretizim/reklamim të grave në mënyre degraduese ose diskriminuese që dhunon dinjitetin personal.

Disa vende anëtare kanë prezantuar dhe mbështetur iniciativa që adresojnë barazinë gjinore në reklama. Në 2018, rregullatori francez CSA publikoi një kapitull kundër stereotipeve seksiste në reklama, i cili u firmos nga industria e reklamave. Në Austri grupet vëzhguese të reklamave u formuan në disa shtete federale dhe shpesh mbështeten nga autoritetet lokale. Në Sllovakia organizata “Sexist Blander” synon rritjen e ndërgjegjësimit mbi seksizmin në reklamat mediatike.

4.2.4 Autoritetet Kombëtare rregulluese

Legjislacioni për autoritetet rregulluese të mediave në fushën e barazisë gjinore, zakonisht është minimal ose shumë i gjerë në qëllim. Megjithatë rregullatorët mund të përdorin parimet e diversitetit, pluralizmit dhe mos diskriminimit për të mbështetur veprimet e tyre në favor të barazisë gjinore.

Raporti thekson ndryshime të mëdha midis autoriteteve rregullatoreve të vendeve të anketuara. 17 vendet që u përgjigjën raportuan zhvillim të limituar në terma të barazisë gjinore, me vetëm katër vende të cilat prezumuan dhe provuan se kanë arritur një nivel të avancuar, përkatësisht Belgjika, Franca, Maqedonia e Veriut dhe Suedia.

Sa i përket strukturave të brendshme të rregullatorëve, shume pak duket se është bërë për të adresuar barazinë gjinore në përgjithësi, përveç rregullatorit Suedez, i cili prodhon një analizë vjetore mbi temën. Pothuaj asnjë rregullator nuk ka mundësuar

trajnime mbi barazinë gjinore të stafit të tyre, përvec rregullatorit të Maqedonisë së Veriut.

Gjysma e rregullatorëve që u përgjigjën (9) raportuan se kanë pasur ankesa lidhur me barazinë gjinore nga publiku gjatë këtyre pesë viteve, por vetëm disa dhanë detaje lidhur me menaxhimin e këtyre ankesave. Një pjese e madhe e tyre deklaroi se procedurat dhe vendimet e tyre janë publike.

Në Francë, ligji i 4 gushtit 2014 i rriti drastikisht kompetencat e CSA-së në lidhje me promovimin e të drejtave të grave dhe barazisë gjinore.

Ndërsa, sa i përket praktikave monitoruese, shumica e autoriteteve rregullatore raportuan se mbikqyrin ose implementojnë rregullime të lidhura me barazinë gjinore. Një aspekt i rëndësishëm i monitorimit është edhe mbledhja e të dhënave. Këshilli Suprem Belg e Francez kanë bërë një punë të jashtëzakonshme në prodhimin e raporteve vjetore duke analizuar prezencën e grave dhe burrave si dhe diversitetit në programet audiovizuale. Rregullatori i Maqedonisë së Veriut AVMU ka përfshirë në faqen e internetit banerin “gjinia dhe media” për të adresuar më specifikisht temën. AVMU **nuk ka detyrim ligjor** në mbledhjen e të dhënave ose përgatitjen e tyre për përfaqësimin e grave dhe burrave. Ata megjithatë, përdorin rezultatet nga studimet vjetore mbi përfaqësimin dhe portretizimin për të debatuar dhe ndërgjegjësuar brenda sektorit audiovizual. Ndryshe ndodh në Francë, ku ligji parashikon se “Kompanitë kombëtare të programeve të përmendur në nenin 44, si dhe shërbimet televizive kombëtare dhe shërbimet radio që i përkasin një rrjeti kombëtar të transmetimit, të transmetuar përmes kanaleve tokësore, i ofrojnë Këshillit të lartë audiovizual (CSA) **tregues cilësorë dhe sasiorë mbi përfaqësimin e grave dhe burrave** në programet e tyre dhe duke i mundësuar bordit të vlerësojë pajtueshmërinë me objektivat e përcaktuara në paragrafin e katërt të nenit 3-1. Ky informacion publikohet në një botim vjetor.”

Duke marrë parasysh kontekstin specifik shqiptar, mendojmë se duhet krijuar rregullim për portretizim të drejtë gjinor në sektorin audiovizual.

4.2.5 Indikatorët e Barazisë gjinore në media

CM/REC 2013 Inkurajon adoptimin dhe implementimin e indikatorëve kombëtarë për barazi gjinore në media duke i përfshirë aktorët kryesorë në proces, dhe ju kërkon vendeve anëtare të “përditësojnë indikatorët e barazisë gjinore rregullisht”.

Dhjetë vende janë përgjigjur se kanë zhvilluar një lloj indikatorësh. Shumica e këtyre vendeve nuk e përfshinë median në këtë proces. Tre vende (Greqia, Serbia dhe Sllovakia) u shprehën se indikatorët e tyre janë frymëzuar nga indikatorët e propozuar nga Instituti European për Barazi Gjinore, (EIGE).

Indikatorët kryesisht mbulojnë përfshirjen e grave në organizata të medias dhe role drejtuese, mbulimin e dhunës ndaj grave, portretizimin gjinor, gjinia në rolet në filma, hendeku i pagës, dhe reklamimi seksist. Irlanda është i vetmi vend që i referohet indikatorëve specifikë për financimin dhe dhënien e licencave të prodhimeve audiovizuale për dhënien e pagesës finale në bazë të të dhënave gjinore në stafin kinematografik dhe pozicionet vendimarrëse.

Si konkluzion, kjo pjesë e studimit tregon se vende të ndryshme e adresojnë në mënyra të ndryshme barazinë gjinore në media, dhe se përfshirja e çështjeve të medias në legjislacionin për barazinë gjinore, është forma më e preferuar për ta bërë këtë.

Shumica e punës së rregullatorëve të aktiviteti të medias e monitorojnë barazinë gjinore në bazë të detyrimit ligjor, por disa prej tyre kanë përdorur iniciativa të tyre për të ndryshuar dhe rritur ndërgjegjësimin mbi çështjet gjinore.

Studimi i vitit 2019 tregon nga ana tjetër se Shqipëria përveçse nuk ka marrë pjesë në studim, duhet gjithsesi të hapë diskutimin publik mbi adoptimin e CM/REC 2013 në kapacitetin që mundet të realizojë.

Shqipëria aktualisht nuk ka zhvilluar indikatorë kombëtarë të barazisë gjinore në media.

PËRFUNDIME

Në përfundim të kësaj analize të legjislacionit Shqiptar dhe atij ndërkombëtar, del qartazi nevoja për një amendim ligjor që rregullon situatën e seksizmit në sektorin e mediave audiovizuale në Shqipëri dhe zbatimin e dispozitave të ligjit të barazisë gjinore në sektorin audiovizual.

Nevoja për përfaqësim gjinor të barabartë në organet vendimarrëse publike të sektorit audiovizual është urgjente.

Rregullimi ligjor duhet të përfshijë përkufizimin, parandalimin dhe lufta ndaj seksizmit në programe informative, reklama apo prodhime audiovizive, në mënyrë që të garantojë një pasqyrim të balancuar gjinor, dhe përfaqësimin e grave në shoqëri në mënyrë të barabartë.

Legjislacioni shqiptar që mbulon rregullimin e sektorin audiovizual dhe barazinë gjinore duhet t'i nënshtrohet procesit të amendimit dhe përditësimit të tij, me rekomandimet e Këshillit të Ministrave të KiE, për garantimin e barazisë gjinore dhe luftës ndaj seksizmit, si edhe adoptimit të shëmbujve më të mire europianë të monitorimit të barazisë gjinore brenda këtij sektori.

Sektori audiovizual duhet të përfaqësohet në mënyrë të balancuar gjinore në organet e tij vendimarrëse publike, dhe barazia gjinore duhet të jetë parim bazë i veprimtarisë së AMA-s edhe gjatë monitorimit të aktivitetit të operatorëve privatë.

Autoriteti i Mediave Audiovizive duhet të monitorojë periodikisht përmbajtjen e ofruesve të shërbimeve mediatike, për të identifikuar situatën e seksizmit dhe barazisë gjinore, si edhe vetë përbërjen e saj, për respektim të balancës gjinore. Po ashtu, Kodi i Transmetimit duhet të shtojë dhe përcaktojë në mënyrë të detajuar seksionin e seksizmit në zbatimin të nenit 26 të ligjit të Barazisë Gjinore.

REKOMANDIME

Lidhur me seksizmin në media

- Rishikimi i Kodit të Transmetimit me qëllim harmonizimin e tij me legjislacionin europian kundër seksizmit, si edhe shtimin e konceptit të luftës ndaj seksizmit në ligjin “Për barazinë gjinore në Shoqëri” sipas propozimeve bashkëlidhur.
- Përfshirja e ligjit “Për barazinë gjinore në shoqëri” në ligjet referuese të Kodit të Transmetimit.
- Fillimin e një fushatë ndërgjegjësuere publike për seksizmin në shoqëri dhe pasojat e tij.
- Trajnimi i stafeve të institucioneve publike mediatike lidhur me barazinë gjinore dhe seksizmin.
- Ngritje kapacitetesh në AMA për metodologjitë e monitorimit të seksizmit në media sipas Observatorit Europian të Audiovizualit.
- Përfshirjen e rekomandimeve të Këshillit të Europës në dy ligjet e mësipërme.
- Krijimi i një vetëdije të re institucionale për pasqyrimin e grave në transmetimet audiovizive, dhe garantimi i një pasqyrimi të balancuar të realitetit social.

Lidhur me barazinë gjinore në trupat vendimmarrëse të sektorit audioviziv :

- Monitorimin e barazisë gjinore në sektorin audiovizual nga Nënkomisioni parlamentar i barazisë gjinore .
- Korigjimi i menjëhershëm i pabarazisë gjinore në RTSH, AMA dhe QKK në rastin më të afërt të rinovimit të trupave drejtuese; ose
- Garantimin me ligj të barazisë gjinore në vendimarrje duke prezantuar në ligjin “Për mediat Audiovizive në Shqipëri” ***detyrimin e përzgjedhjes/emërimit në numër të barabartë për cdo gjini*** për organet vendimmarrëse publike (AMA, QKK, RTSH) me nen të posacëm.

REFERENCA

- <https://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/cedaw.aspx>
- <https://rm.coe.int/prems-055519-gbr-2573-cmrec-2019-1-weba5/168093e08c>
- https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectID=09000016807509e6
- https://www.gadc.org.al/media/files/upload/Ceshtjet_e_barazise_gjinore_ne_sektorin_audioviziv_ne_shqiperi.pdf
- https://www.mod.gov.al/images/PDF/barazia_gjinore_shoqeri.pdf
- https://www.uart.edu.al/media/150329-Ligji%2010221_%202010%20per%20mbrojtjen%20nga%20%20diskriminimi.pdf
- <http://ama.gov.al/wp-content/uploads/2018/05/Kodi-i-Transmetimit-pwr-Median-Audiovizive.pdf>
- <https://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/20200121101826ligji%20nr%20%2091%20dt%20%2018%2012%202019.pdf>
- *Ermira Danaj, Punim mbi Këshillin e Lartë Audiovizual Francez*
- *Valbona Sulce, Portretizimi i gruas në media, Instituti Shqiptar i Medias, 2018.*
- <https://rm.coe.int/prems-064620-gbr-2573-gender-equality-inmedia/16809f0342>
- http://www.un.org.al/sites/default/files/1.%20Gender%20ne%20Partite%20Politike%202017%20-%20Shqip_1.pdf
- <https://rm.coe.int/prems-064620-gbr-2573-gender-equality-inmedia/16809f0342>

Aneks

Rekomandime për forcimin e integritit gjinor në ligjin për mediat audio-vizuale në Shqipëri

Në përputhje me Ligjin mbi mediat audiovizuale si dhe në harmoni me ligjin për barazinë gjinore në kuadër të respektimit të përfshirjes gjinore, mosdiskriminimit, aftësisë fizike mendore, etj., shtrija e përfshirjes së barabartë gjinorë në nivelet përfaqësuese, kryesisht bordet drejtuese të AMA-s, dhe RTSH-së, ka mundësi të jetë më e madhe dhe në koherence me ligjin për barazinë gjinore. Përfshirja në parimet baze të ligjit për mediat audiovizive të parimeve të mosdiskriminimit apo promovimit të barazisë gjinore me të gjitha mjetet e nevojshme do shmangte çdo lloj diskriminimi të drejtpërdrejtë apo të tërthortë.

- AMA

Nenet 8 dhe 9 të ligjit për mediat audiovizive përcaktojnë se AMA përbëhet nga Kryetari, Zëvendëskryetari dhe 5 anëtarë. Kandidat për t'u zgjedhur anëtar i AMA-s mund të jetë çdo person, i cili ka përvojë pune jo më pak se 10 vjeçare në fushat e përcaktuara në ligj. Anëtarët e AMA-s zgjidhen nga Kuvendi për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.

Në një vështrim të përgjithshëm, ligji është shkruar në mënyrë të mirë nga pikëpamja e teknikës legjislative dhe në të nuk ka asnjë element të diskriminimit, por duke parë që nga pikëpamja praktike detyrimi për integritin gjinor nuk është respektuar ndër vite, nevoja për një rregullim ligjor është urgjent dhe imediat.

- RTSH

Brenda RTSH-së janë të ngritura dy organe drejtuese kryesore kolegjinale a) Këshilli Drejtues (KDRTSH). dhe Bordi i Administrimit. KDRTSH-ja përbëhet nga Kryetari dhe 10 anëtarë. Bordi i Administrimit përbëhet nga 5 anëtarë, 3 të brendshëm dhe 2 të jashtëm, të cilët janë ekspertë në problemet e administrimit, financës dhe biznesit. Anëtarët e Bordit të Administrimit caktohen për një periudhë 4-vjeçare dhe mund të ricaktohen për dy periudha të tjera, në rast se gjatë kësaj kohe nuk kapërcejnë kufirin e moshës për pension. Veç tyre RTSHja krijon këshillin për shikuesit dhe dëgjuesit. Ky këshill përbëhet nga 15 anëtarë, të zgjedhur nga KDRTSHja, mes anëtarëve të saj, gazetarëve ose punonjësve të tjerë të RTSH-së dhe të paktën dy të tretat prej tyre të jenë përfaqësues të jashtëm të kategorive të ndryshme shoqërore.

Në dritën e fakteve të mësipërme dhe në kuadër të organizimit të institucioneve dhe sidomos organeve të tyre drejtuese, rekomandohet të bëhet edhe ndryshimi në përbërjen e strukturës së bordeve të drejtuese apo të përfaqësimit, ku detyrimi për të siguruar që për këshill apo bord të ketë së paku 30% të kandidatëve nga secila gjini. Rregullimi nuk duhet të ndalet vetëm në rregullimin ligjor por edhe në aktet nënligjore që dalin në zbatim të ligjit.

5.1. Mënyrat kryesore të ndërhyrjes

Në thelb, rekomandohet që kuotat të jenë neutrale ndaj çështjeve gjinore kështu që ato nuk mund të jenë të keqkuptuara si diskriminuese ndaj meshkujve apo femrave.

- **Rekomandimi nr. 1:** Ligjërimi i kuotave të kandidatëve

Meqë përfaqësimi në këshillat drejtuese apo bordet është i rregulluar me ligj, kuotat e përfaqësimit të kandidatëve duhet të përcaktohen që në ligj për të siguruar që një numër minimal kandidatësh të jenë femra, ose nëse kuota është neutrale ndaj gjinisë, rregullimi ligjor do të jetë për shembull, “jo më shumë se 70 për qind dhe jo më pak se 30 për qind të jetë e secilës prej gjinive”. Në rastin konkret, në ligjin për mediat audiovizive ky togfjalësh mund t'i shtohet pikës 1 të nenit 8 ose pikës 1 të nenit 9, pikën 1 të nenit 93 ose pikës 1 të nenit 94, pikën 2 të nenit 107 dhe pikën 2 të nenit 115.

Shembull:

LIGJ

Nr. ____/2019

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 97/2013, “PËR MEDIAT AUDIOVIZIVE
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 84, pika 4, të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhet ndryshimi si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 8, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. AMA përbëhet nga Kryetari, Zëvendëskryetari dhe 5 anëtarë, nga të cilët jo më shumë se 70 për qind dhe jo më pak se 30 për qind i përkasin secilës prej gjinive”.

Neni 2

Në nenin 93, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. KDRTSH-ja përbëhet nga Kryetari dhe 10 anëtarë, nga të cilët jo më shumë se 70 për qind dhe jo më pak se 30 për qind i përkasin secilës prej gjinive”.

Neni 3

Në nenin 107, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Bordi i Administrimit përbëhet nga 5 anëtarë, 3 të brendshëm dhe 2 të jashtëm, nga të cilët jo më shumë se 70 për qind dhe jo më pak se 30 për qind i përkasin secilës prej gjinive. Anëtarët e Bordit të Administrimi janë ekspertë në problemet e administrimit, financës dhe biznesit dhe caktohen për një periudhë 4-vjeçare me të drejtë ricatimi për dy periudha të tjera, në rast se gjatë kësaj kohe nuk kapërcejnë kufirin e moshës për pension”.

Neni 3 Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Miratuar në datën _____.2021

- **Rekomandimi nr. 2:** Sanksionet për mospërputhje

Sanksionet janë të nevojshme për të siguruar respektimin e kuotave gjinore. Prandaj është e rekomandueshme që në ligjin për barazinë gjinore, konkretisht në nenin 28 të tij te shtohet sanksion për mos zbatimin e nenit 15 (i cili garanton pjesëmarrje të barabartë gjinore në procesin vendimmarrës, pra pikërisht në këshillat drejtuese apo bordin e administrimit të AMA-s dhe RTSH-së) duke detyruar respektimin e kuotave gjinore jo vetëm në ligjin kuadër, që është ai i barazisë gjinore por edhe në ligjet e posaçme si ai i mediave audiovizive. Rekomandohet që mekanizmat e zbatimit të shkojnë përtej dënimeve financiare, dhe në vijim të tyre, sanksionet duhet të mundësojnë pavlefshmërinë e përzgjedhjes nëse kuotat gjinore nuk janë respektuar.

- **Rekomandimi nr. 3:** Vende të rezervuara në këshillat përkatës

Ky rekomandim ka të bëjë me përdorimin e një gjuhe jo neutrale por të drejtpërdrejtë. Në ligjin për mediat audivizive të përcaktohet numri ekzakt i vendeve në këshillat përkatës të rezervuar për femrat. Për shembull në nenin 93, pika 1, i cili thotë se KDRTSH-ja përbëhet nga Kryetari dhe 10 anëtarë, të shtohet togfjalëshi nga të cilët 5 anëtarë duhet ti përkasin gjinisë femërore. Natyrisht nga pikëpamja e shkrimit dhe arsyetimit ligjor, kjo nuk është mënyra më e mirë për të ndërhyrë, por është një mjet që teknika legjislativë e njeh dhe mund të përdoret.

Rekomandime për ndryshime në Ligjin “Për mediat Audiovizuale në Shqipëri”
Nr 1497 dt 97/2003

- “Përkufizime” pika 38, Rekomandohet shtimi i paragrafit si më poshtë:
38) Seksizëm konsiderohet: “Cdo akt, gjest, përfaqësim vizual, fjalë të shkruara ose të thëna, praktika ose sjellje të bazuara në idenë se një person ose grup personash është inferior për shkak të gjinisë, që ndodh në sferën publike ose private, online ose offline, me efekt qëllim:
 - **Dhunim të dinjitetit inherent ose të drejtat e një personi ose grup personash ose;**
 - **Që rezulton në dëm ose vuajtje fizike, seksuale, psikologjike ose socio-ekonomike ndaj një përsonei ose grup personash ose;**
 - **Krijimin e një mjedisi intimidues, armiqësor, degradues, fyes dhe poshtëruës, ose;**
 - **Ruajtja dhe përforcimi i stereotipeve gjinore.”**
- Neni 4 “Parimet themelore për veprimtarinë e transmetimeve audiovizive”, pika 2 rekomandohet shtimi i pikës e) **parimit të mosdiskriminimit gjinor dhe përfaqesimit të balancuar të realitetit social.**
- Neni 9 “Zgjedhja e anëtarëve/anetareve AMA-s” rekomandohet shtimi i nenit 1/b si më poshtë: **Anëtarë/et e AMA-s zgjidhen sipas parashikimit të ligjit për barazinë gjinore të përfaqësimit të barabartë gjinor mbi 30% për secilën gjini.**

- Në nenin 4/b të nenit 9 rekomandohet shtimi i togëfjalëshit: “**Kandidatë/et e propozuar duhet të përmbushin kriterin e përfaqësimit të barabatë gjinor me jo me pak së 30 përqind midis gjinive**”.
- Neni 20, Këshilli i Ankesave rekomandohet shtimi i togëfjalëshit: “**Këshili i Ankesave garanton respektimin e dinjitetit të të gjithë personave dhe imazhin e grave në programet audiovizive**”.
- Neni 33 “Detyrimet e OSHMAVE” rekomandohet shtimi i dy neneve të mëposhtme poshtë pikave c dhe ç:
 - a. **Të paraqesë në mënyrë të balancuar realitetin social;**
 - b. **Të mos transmetojë programe që janë seksiste, objektifikuese, stereotipizuese, degraduese ose fyese ndaj grave dhe burrave;**
- Neni 42 Komunikimet me natyrë tregtare”, rekomandohet shtimi në pikën 6 i togëfjalëshit të mëposhtëm: “**Komunikimet me natyrë tregtare në transmetimet audiovizive për produkte të cilat pasqyrojnë materiale seksiste, objektifikuese dhe stereotipizuese janë të ndaluara**”.
- Neni 94 Zgjedhja e Anëtarëve të KDRTSH me shtesën e mëposhtme: Në çdo rast komisioni mban parasysh ruajtjen e balancës, pesë kandidatë të mbështetur nga maxhoranca, pesë të mbështetur nga opozita, **njëkohësisht balancën gjinore sipas ligjit të barazisë gjinore**. Kandidatët për anëtarë të KDRTSH-së i propozohen për miratim seancës plenare.

Rekomandime pwr disa ndryshime KODIN E TRANSMETIMIT PËR MEDIAN AUDIOVIZIVE (Miratuar me Vendimin e AMA-s, nr. 228, datë 11.12.2017)

- Në Parag 4 “Parimet të përgjithshme” rekomandohet shtimi i togefjalëshit, ***eliminimin e seksizmit, garantimin e barazisë gjinore si më poshtë:***

“Në thelb, Kodi i Transmetimit përmban parimet bazë të transmetimit, si dhe rregullon veprimtarinë audiovizive, pothuaj në të gjithë gamën e saj të shumanshme e të larmishme në stadin aktual. Kodi është strukturuar në seksione të ndryshme që përfshijnë parime e rregulla për programet informative, për mbrojtjen e fëmijëve në programet e të gjitha llojeve, kundër dhunës së skajshme në ekran, për komunikimet e ndryshme tregtare, respektimin e dinjitetit, ***eliminimin e seksizmit, garantimin e barazisë gjinore***, mbrojtjen e të dhënave personale e të personave me aftësi të kufizuar etj.”

- Shtimi i ligjit për barazinë gjinore tek Baza Gjinore si më poshtë:

1) Kodi i Transmetimit, i hartuar dhe i miratuar nga AMA, sipas detyrimit të parashikuar në nenin 46 të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, vendos rregullat, standardet dhe praktikatat e transmetimit në përputhje me përcaktimet e akteve ligjore dhe nënligjore të mëposhtme:

8. Ligji Nr. 9970, datë 24.7.2008 “Per barazine gjinore në Shqipëri”

- Në pikën 3 të seksionit “Baza Ligjore” shtimin e paragrafëve të mëposhtëm:

Seksizëm konsiderohet: “Cdo akt, gjest, përfaqësim vizual, fjalë të shkruara ose të thëna, praktika ose sjellje të bazuara në idenë se një person ose grup personash është inferior për shkak të gjinisë, që ndodh në sferën publike ose private, online ose offline, me efekt dhe qëllim:

- **Dhunim të dinjitetit inherent ose të drejtat e një personi ose grup personash ose;**
- **Që rezulton në dëm ose vuajtje fizike, seksuale, psikologjike ose socio-ekonomike ndaj një përsonei ose grup personash ose;**
- **Krijimin e një mjedisi intimidues, armiqësor, degradues, fyes dhe poshtërues, ose;**
- **Ruajtja dhe përforcimi i stereotipeve gjinore.”**

Kodi i Transmetimit është hartuar në zbatim të akteve ndërkombëtare për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut:

“Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe Lirive Themelore” (e vitit 1998), neni 8, neni 9, neni 10 dhe neni 14.

- **Rekomandimit CM/REC (2019) 1 “mbi Parandalimin dhe Luftimin e Seksizmit” të Komitetit të ministrave të Këshillit të Europës.**
- **Rekomandimit CM/REC (2013) 1” Mbi Barazinë Gjinore dhe Median” Komitetit të ministrave të Këshillit të Europës.**
- **Konventa e OKB-së “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës” (e vitit 1989).**
- **Konventa e OKB-së “Mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave “CEDAEW (e vitit 1979).**

- Tek seksioni 1 “Parimet Themelore” shtimi i togëfjalëshit barazi gjinore si më poshtë:

Parimet themelore që përbëjnë bazën e zhvillimit të veprimtarisë audiovizive, e cila mbështetet në garantimin e lirisë dhe të pluralizmit të mjeteve të komunikimit audioviziv janë si më poshtë vijon:

1. Operatorët e shërbimit mediatic audioviziv, gjatë zhvillimit të veprimtarisë së tyre, garantojnë e respektojnë lirinë dhe të drejtat e njeriut, lirinë e shprehjes, **barazinë gjinore** të drejtën e informimit, parimin e mosdiskriminimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

- Tek seksioni “ Këshilli i Ankesave” shtimin e nenit 2.5 si më poshtë:

2.5 Çdo 6 muaj Këshilli i Ankesave boton një përmbledhje të përfundimeve të nxjerra, në bazë të pikës 2.4 më sipër, në një buletin të vecantë që botohet nga AMA.

-Tek seksioni 7 “reklammat në transmetimet audiovizive” shtimi i neneve si më poshtë:

7.1 Transmetimi i reklamave nga OSHMA-të duhet të mbajë parasysh kërkesat e legjislacionit në fuqi, veçanërisht për reklammat e ndaluara si dhe reklammat e fshehura.

7.2 OSHMA-ve u ndalohet të përdorin gjatë transmetimit të reklamave, mënyra të joshjes së shikuesve në mënyrë të pandërgjegjshme dhe teknika për sugjestionimin e tyre.

7.3 **OSHMA-të nuk duhet të pranojnë apo të transmetojnë reklama që nxisin diskriminimin, që nuk respektojnë dinjitetin dhe të drejtat e njeriut.**

7.4 OSHMA-të nuk duhet të transmetojnë reklama që synojnë objektifikim ose fuqizimin e stereotipave ndaj grave; OSHMA-të nuk duhet të prodhojnë ose transmetojnë reklama të cilat paraqesin materiale seksiste, fyese, denigruese ose krijojnë hapësirë për shkelje të të drejtave të grave dhe dhunës me bazë gjinore;